

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS

Nr. 82119 Prot.

Datë: 09.01.2020

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 19, datë 9.01.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË: "BACHELOR NË MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR", "BACHELOR NË HISTORI-GJEOGRAFI", "BACHELOR NË PEDAGOGJINË E SPECIALIZUAR SOCIALE", "BACHELOR NË MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR"

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në mësuesi për arsimin fillor" (bashkëlidhur).
2. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në histori-gjeografi" (bashkëlidhur).
3. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në pedagogjinë e specializuar sociale" (bashkëlidhur).
4. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në mësuesi për arsimin parashkollor" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland Zisi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË
PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR NË MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR"**

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Edukimit. Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" bazuar në Vendimin Nr. 149 date 4.08.1998, 2909/1 (prot), "Per hapjen e kursit te studimit universitar te Ciklit te Ulet ne Universitetin Teknologjik Ismail Qemali te Vlores; Bazuar ne Ligjin nr. 7967 date 20.7.1995; Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7810 date 6.4.1994 Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise neni 11 me propozim te Rektoratit te Universitetit Teknologjik Ismail Qemali te Vlores dhe Drejtorise se Arsimit te Larte. Kohezgjatja e kursit te studimit 4 vjet.

Në rregullore përcaktohen kërkesat kryesore, procedurat dhe pritshmëritë që duhen ndjekur dhe respektuar për të mundur ndjekjen e rregullt dhe të suksesshme në programin "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" nga një masë sa më e madhe pjesëmarrësish që e dëshirojnë atë.

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Neni 2

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, në fushën e Edukimit dhe të mësimdhënies.

Neni 3

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Humane të UV.

II . Pranimi i kandidatëve

Neni 4

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Humane, UV dhe drejtohet nga Departamenti i Edukimit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 5

Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" bëhet sipas kriterëve të miratuara nga DE në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga MASR në RSH.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 6

Regjistrimet e studentëve në programin e studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" kryhet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Edukimit (DE) në Fakultetin e Shkencave Humane (FSHH).

Neni 7

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHH dhe UV.

Neni 8

Në programin e studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHH.

III. Organizimi i studimeve

Neni 9

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" përfundon me marrjen e diplomës përkatëse "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor". Për marrjen e diplomës "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor", pjesëmarrësi në program duhet të marrë 180 kredite, (ECTS), me një total prej 1500 orësh, të shpërndara në raportet 15-20% (kredite) Lëndë të përgjithshme (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme), 50-55% (kredite) Lëndë karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore), 12-15% (kredite) Lëndë ndërdisiplinore/integruese (nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje), 10-15% (kredite) Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale dhe 3-5% (kredite) Detyrime përmbyllëse. Shpërndarja e krediteve në programin "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" është si më poshtë :

- Disiplinat e formimit të përgjithshëm kanë përkatësisht 32 (kredite).
- Disiplinat e formimit karakterizues të programit kanë 96 (kredite).
- Disiplinat formuese dhe integruese 20 (kredite).
- Veprimtaritë formuese për njohjen e gjuhës së huaj dhe praktike 26 (kredite).
- Përgatitja e temës së diplomës 6 (kredite).

Diplomat që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.


Neni 10

Programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Neni 11

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" është gjuha shqipe.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 12

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, **"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"**. Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve, ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nenshtruar detyrimeve që lindin nga kohezgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 13

Leksionet zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHH. Orari i shpallet përpara fillimit të semestrit në websitin e universitetit dhe ambjentet e fakultetit. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimi, pedagogët mësimdhënës. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimi dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20–25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

Neni 14

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit, kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyrë në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.


Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

Neni 15

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.

Neni 16

Studentët kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktuara nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomes, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 17

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHH. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me rregjistrin përkates, i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (M) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (M) do të do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 18

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, në semestrin e dytë të vitit të tretë. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Neni 19

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 9.0. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomes bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.


Neni 20

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimtare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Edukimit dhe Sekretarinë Mësimore të FSHH.

Neni 21

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor" të firmosur nga Dekani i FSHH dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË
PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR NË HISTORI-GJEOGRAFI"**

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë (UV).

Programi i studimit Bachelor në Histori Gjeografi është hapur me vendimin nga MASH me urdhër Nr. 270, datë 10/06/2011, me strukturë didaktike 3 vjeçare. Starton në vitin akademik 2011-2012 dhe diploma e lëshuar nga ky program titullohet dhe regjistrohet Bachelor në Histori-Gjeografi.

Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, në fushën e shkencave historike e gjeografike.

Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Humane të UV.

II. Pranimi kandidatëve

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Humane, UV dhe drejtohet nga Departamenti i Edukimit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 5

Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit Bachelor në Histori-Gjeografi bëhet sipas listave përkatëse të miratuara nga MASR.

Neni 6

Regjistrimet e studentëve fitues, të shpallur nga IAL-të për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane (FSHH) dhe pasqyrohen në portalin e aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.al>

Neni 7

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHH dhe UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 8

Në programin e studimit Bachelor në Histori-Gjeografi kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHH.

III. Organizimi i studimeve

Neni 9

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi përfundon me marrjen e diplomës përkatëse "Bachelor në Histori-Gjeografi". Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti është 180 kredite ECTS. Diploma që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.

Neni 10

Programi i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet dhe provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Neni 11

Gjuha në të cilën zhvillohet program i studimit Bachelor në Histori-Gjeografi është gjuha shqipe.

Neni 12

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin **Nr. 80/2015**, datë 22.07.2015, **"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"**. Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 13

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHH. Orari shpallet përpara fillimit të semestrit në websitin e universitetit dhe ambjentet e fakultetit. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimit, pedagogët mësimdhënës. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimit dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20-25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

Neni 14

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Për semestrin e verës dhe sezonin e rriprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.

Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

Neni 15

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.

Neni 16

Studentët kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.

Neni 17

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe praktikave në terren përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHH. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 18

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës në terren, në semestrin e dytë të vitit të parë. Praktika në terren realizohet pranë qendrave historike, arkeologjike, muzeale, parqeve natyrore. Praktika do të kryhet nën mbikëqyrjen e pedagogut të lëndës. Me fillimin e semestrit, pedagogu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

udhëheqës u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Neni 19

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 9.0. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të percaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.

Neni 20

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Edukimit dhe Sekretarinë Mësimore të FSHH.

Neni 21

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Histori-Gjeografi" të firmosur nga Dekani i FSHH dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.

Neni 22

BACHELOR në Histori-Gjeografi, përpara se të lëshohen nga Universiteti "Ismail Qemali", duhet të regjistrohen në regjistrin shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në MASH, në bazë të Nenit 31 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Neni 23

Struktura Akademike Përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin administrativ e financiar të programit të studimit është FSHH dhe Departamenti i Edukimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË
PROGRAMIN E STUDIMIT**

"BACHELOR NË PEDAGOGJINË E SPECIALIZUAR SOCIALE"

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Edukimit. Programi i studimit Pedagogjia e Specializuar Sociale është hapur në tetor 2003, MASH si program studimesh 3 vjeçare dhe në vitin akademik 2011-2012, me urdhër të MASH, diploma e lëshuar nga ky program regjistrohet si "Bachelor" në Pedagogjinë e Specializuar Sociale.

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, në fushën e Edukimit të Specializuar.

Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Humane të UV.

II. Pranimi kandidatëve

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Humane të UV dhe drejtohet nga Departamenti i Edukimit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 5

Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale bëhet sipas kriterëve të miratuara nga DE në përputhje me aktet nënfigjore të miratuara nga MASR në RSH.

Neni 6

Regjistrimet e studentëve në programin i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale kryhet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Edukimit (DE) në Fakultetin e Shkencave Humane (FSHH).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 7

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHH dhe UV.

Neni 8

Në programin e studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHH.

III. Organizimi i studimeve

Neni 9

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale përfundon me marrjen e diplomës përkatëse "Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale". Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti është 180 kredite. Diplomat që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.

Neni 10

Programi i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Neni 11

Gjuha në të cilën zhvillohet program i studimit Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale është gjuha shqipe.

Neni 12

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin **Nr. 80/2015**, datë 22.07.2015, **"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"**. Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve, ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nenshtruar detyrimeve që lindin nga kohezgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 13

Leksionet zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHH. Orari i shpallet përpara fillimit të semestrit në ëëbsitin e universitetit dhe ambjentet e fakultetit. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimit, pedagogjik-mësimdhënës. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimit dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20–25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

Neni 14





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit, kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.

Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

Neni 15

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.

Neni 16

Studentët kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktuara nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomes, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojnë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.

Neni 17

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHH. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlllogaritët për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës, i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 18

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, në semestrin e dytë të vitit të tretë. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Neni 19

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 9.0. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomes bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.

Neni 20

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Edukimit dhe Sekretarinë Mësimore të FSHH.

Neni 21

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Pedagogjinë e Specializuar Sociale" të firmosur nga Dekani i FSHH dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË
PROGRAMIN E STUDIMIT**

"BACHELOR NË MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR"

I.Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Edukimit. Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është hapur në 17.06.2002, bazuar në Ligjin Nr. 8461 datë 25.02.1999 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 13, me propozim të senatit të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, e cila do të zhvillohet pranë Departamenti i Mësuesisë. Programi i studimit me Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, është e organizuar në 180 Kredite (ECTS), me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi Arsimin Parashkollor është hartuar në përputhje me nevojat e shkollës e të tregut të punës. Politikat zhvillimore në Departamentin e Edukimit janë hartuar në përputhje me zhvillimin arsimor, social, ekonomik të shoqërisë sonë dhe se çfarë ofron tregu. Sigurisht, që edhe ky program studimi është hartuar duke patur parasysh këtë kriter, për punësimin më pas të diplomuarve.

Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Humane të UV.

II. Pranimi kandidatëve

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi Arsimin Parashkollor realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Humane të UV dhe drejtohet nga Departamenti i Edukimit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor bëhet sipas listave përkatëse të miratuara nga MASR.

Neni 6

Regjistrimet e studentëve në programin i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor kryhet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Edukimit (DE) në Fakultetin e Shkencave Humane (FSHH).

Neni 7

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHH dhe UV.

Neni 8

Në programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHH.

III. Organizimi i studimeve

Neni 9

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor përfundon me marrjen e diplomës përkatëse Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti është 180 kredite. Diplomat që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.

Neni 10

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Neni 11

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është gjuha shqipe.

Neni 12

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, **"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"**. Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve, ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohezgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 13





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Leksionet zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHH. Orari i shpallet përpara fillimit të semestrit në websitin e universitetit dhe ambjentet e fakultetit. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimi, pedagogët mësimdhënës. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimi dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20–25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

Neni 14

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit, kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.

Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

Neni 15


Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni Dekanin.

Neni 16

Studentët kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga Dekani i Fakultetit para mbrojtjes së diplomes, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.

Neni 17

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHH. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlogaritet për gjithë semestrin përkundëjt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkates, i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 18

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, në semestrin e dytë të vitit të tretë. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Neni 19

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 9.0. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomes bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.

Neni 20

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimtare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Edukimit dhe Sekretarinë Mësimore të FSHH.

Neni 21

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" të firmosur nga Dekani i FSHH dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.



Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele



Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al